

SHOQËRI TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TE
KUFIZUAR

STATUTI
I SHOQËRISË

“NIKI GO TRANS” sh.p.k.

DURRËS – ALBANIA

Durres, me 09. 09. 2021



A handwritten signature in black ink, consisting of a stylized, cursive script.

NIKI GO TRANS SHPK

Përmbajtja

Neni.1 - Emri.....	2
Neni. 2 – Selia ligjore dhe vendqendrimi i ortakëve.....	2
Art. 3 - Objekti i shoqërisë.....	2
Art. 4 - Kohëzgjatja (jetëgjatësia) e shoqërisë.....	3
Art. 5 - Kapitali i shoqërisë , kuotat e pjesemarrjes.....	3
Art. 6 - Blerja dhe Transferimi i kuotave.....	3
Art. 7 - Vendimet e ortakëve.....	3
Art. 8 - Efikasiteti i vendimarrjes së asamblesë.....	4
Art. 9 - Thirrja dhe vendi i mbajtjes së Asamblesë.....	4
Art. 10 - Ndërhyrja dhe përfaqësimi në asamble.....	4
Art. 11- Presidenti i asamblesë.....	5
Art. 12 - Vendimet e asamblesë.....	5
Art. 13 - Administrimi i shoqërisë.....	5
Art. 14 - Presidenti , zëvendës presidenti dhe administratori i deleguar.....	6
Art. 15 - Vendimet e Këshillit të Administrimit.....	6
Art. 16 - Mbledhja kolegjiale e Këshillit të Administrimit.....	6
Art. 17 - Vendimet e marra me mbledhje kolegjiale.....	6
Art. 18 - Fuqitë e organit administrativ.....	6
Art.19 - Firma dhe përfaqësimi i shoqërisë.....	7
Art.20 - Organi i kontrollit.....	7
Art.21- Viti fiskal ushtrimor, bilanci dhe fitimet.....	7
Art.22 – Shkrirja ose prishja e shoqërisë.....	7
Art.23 - Dispozitat e përgjithshme.....	8



**SHOQËRI TREGËTARE SIPAS SË DREJTËS SHQIPTARE ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR DHE ORTAK TË VETËM**

NIKI GO TRANS SHPK
DURRES - ALBANIA

STATUTI

TITULLI I (EMËRTIMI – OBJEKTI – KOHËZGJATJA – SELIA)

Art. 1 – Emërtimi

1.1 është themeluar ne Durrës një shoqëri tregtare me një ortak të vetëm me përgjegjësi të kufizuar nën emërtimin " NIKI GO TRANS " SH.P.K , një emër që do të shtypet edhe në vulën e kompanisë.

Art. 2 – Selia e shoqërisë dhe vendqëndrimi i ortakëve

2.1 Shoqëria ka selinë zyrtare (ligjore) në Durrës, Lagja 1, Rruga "Nako Spiro", Zone Kadastrale nr.8512, nr. pasurie 23/328-N20, Prane Viles se mbretit Zog.

2.2 Shoqëria, do të kryejë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe atë ndërkombëtar pa asnjë kufizim. Sipas modaliteteve ligjore dhe vendimarrjes së Organit të Administrimit, shoqëria mund të krijojë dhe mbyllë (nëse janë krijuar më parë) filiale , degë, agjensi, përfaqësi (zyra përfaqësimi) ,magazina dhe depo , pika kontakti dhe zyra në cdo vend të Shqipërisë dhe jashtë saj.

2.3 Vendqëndrimi i ortakëve , përta i përket marrëdhënieve me shoqërinë, është ai i përcaktuar në aktin e themelimit, ose më saktë në komunikimin e fundit (shpalljen) të bërë nga shoqëria.

Art. 3 – Objekti i shoqërisë

3.1 Shoqëria "NIKI GO TRANS" SH.P.K ka si objekt të saj:

- Transport rrugor kombëtar dhe ndërkombëtar mallrash për të tretë e me qira.
- Shoqëria mund të ushtrojë të gjitha aktivitetet e tjera tregtare, industriale dhe financiare, operimin me pasuri të tundshme dhe të patundshme, që nga organet administratuese do të konsiderohen si aktivitete operative, shtesë, të lidhura, të domosdoshme apo të dobishme për realizimin e aktivitetit që përbëjnë objektin social të shoqërisë, të kërkojë interesa apo të ndërmarrë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera që kanë si objekt aktivitete analoge, të përafërta, të lidhura me të sajat, si në menyrë direkte ashtu edhe indirekte, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë shtetit, e gjithashtu të japë garanci dhe të ofrojë dorëzani në favor të të tretëve, edhe pa pagesë, e gjitha kjo për sa kohë këto aktivitete të mos kryhen në ngarkim të publikut dhe masa e ushtrimit të tyre të mos jetë mbizotëruese në raport me ato aktivitete që përbëjnë qëllimin social.

Art. 4 – Kohëzgjatja (jetëgjatësia) e shoqërisë

4.1 Jetëgjatësia e shoqërisë është e përcaktuar me KOHË TË PAKUFIZUAR, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe certifikimin e saj si person juridik.

4.2 Kohëzgjatja e kompanisë mund të ndryshohet në cdo kohë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Vendimi duhet të komunikohet dhe të depozitohet menjëherë tek organi kompetent (QKB) në mënyrë që ky i fundit të mund të bëjë ndryshimet e nevojshme në Regjistrin Tregtar.

4.3 Kompania do të kryejë veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi, konventat ndërkombëtare të ratifikuara si dhe në bazë të këtij Statuti dhe të Ligjit 9901, datë 04/14/2018 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"



TITULLI II

KAPITALI I SHOQËRISË DHE PJESËMARRJA E ORTAKËVE

Art. 5 – Kapitali i shoqërisë , kuotat e pjesmarrjes.

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Lekë dhe në kohën e themelimit përbëhet nga një kuotë e vetme e caktuar tërësisht për ortakun e vetëm, shoqërinë " NIKI GO TRANS " SH.P.K siç parashikohet në aktin e themelimit; ky i fundit mund të rritet ose zvogëlohet me vendim të posaçëm të mbledhjes së ortakëve dhe kontributet mund të bëhen gjithashtu në natyrë ose në kredi.

5.2 Të drejtat mbi shoqërinë u përkasin ortakëve në përputhje me masën proporcionale të pjesëmarrjes që disponon secili ortak.

Art. 6 – Transferimi i kuotave.

6.1. Siç parashikohet në legjislacionin në fuqi, kuotat e shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen ose transferohen vetëm përmes:

- a) kontributit direkt në kapitalin aksionar;
- b) shitjes;
- c) kalimit trashëgimor;
- ç) dhurimit;
- d) në çfarëdolloj mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

6.2 Transferimi i kuotave ndërmjet të gjallëve mund të bëhet vetëm në favor të ortakëve të rinj, për të cilët asambleja me shumicën e kapitalit të shoqërisë, ka dhënë miratimin e saj, duke rezervuar paraprakisht të drejtën e parablerjes në favor të ortakëve të tjerë.

Rrjedhimisht ortaku ofrues (që dëshiron të largohet) duhet të njoftojë anëtarët e tjerë nëpërmjet një letre rekomande në të cilën të përcaktohet çmimi dhe modalitetet e shitjes dhe ortakët e tjerë brenda 30 (tridhjetë) ditëve do të duhet të shprehin vullnetin e tyre për të blerë. Në rast të mungesës së vullnetit për të ushtruar të drejtën e parablerjes, asambleja duhet të miratojë pëlqimin e saj për ortakët e rinj brenda 15 ditëve.

6.3 Në rast vdekjeje të një prej ortakëve, mbledhja e aksionarëve rezervon të drejtën të pranojë trashëgimtarët si ortakë ose të likuidojë pjesëmarrjen e tyre në një vlerë kontabël të barabartë me kapitalin neto që rezulton në kohën e vdekjes.

6.4 Transferimi i aksioneve duhet të bëhet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim.

TITULLI III

VENDIMET E ASAMBLESE SË ORTAKËVE

Art. 7 – Vendimet e ortakëve

7.1. Siç përcaktohet me nenin 82 të Ligjit 9901 të datës 14/04/2008, anëtarët vendosin nëpërmjet "Asamblesë së Ortakëve" për çështjet e mëposhtme të cilat janë të rezervuara për kompetencat e tyre:

1. përcaktimin e politikave tregtare dhe të drejtimit të shoqërisë;
2. ndryshimet në Statut;
3. vendimet për të kryer operacione që përfshijnë një ndryshim në objektin e shoqërisë ose një ndryshim në të drejtat e ortakëve;
4. vendime në lidhje me shpërndarjen e fitimeve;
5. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve si dhe përcaktimin e shpërblimit të tyre;
6. emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
7. miratimin e pasqyrave financiare;
8. vënien në likuidim të shoqërisë dhe emërimin e likuidatorëve;
9. çdo lloj tjetër vendimi për të cilin të paktën një nga administratorët kërkon mbledhjen e



asamblesë.

7.2 Asambletë e zakonshme dhe të jashtëzakonshme do të mund të mbahen edhe jashtë selisë ligjore të shoqërisë, qoftë edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Asambletë mund të mbahen edhe në audio – videokonferencë për sa kohë janë siguruar të drejtat e pjesëmarrjes si më poshtë:

1. duhet të zgjidhet një vend ku të jenë të pranishëm presidenti dhe sekretari i mbledhjes.
2. Duhet të bëhet i mundur identifikimi i saktë i personave të legjitimuar për të marrë pjesë në mbledhje;
3. duhet të sigurohet mundësia e gjithsecilit për të ndërhyrë verbalisht mbi të gjitha argumentet e trajtuara si edhe për të vrojtuar apo marrë dhe përcjellë informacion në kohë reale. Egzistenca reale e të drejtave në fjalë duhet të konstatohet nga presidenti i mbledhjes i cili duhet t'i regjistrojë në procesverbalin e mbledhjes.

7.3 Në rastin kur asambleja duhet të mbahet ne audio – videokonferencë ose në audiokonferencë , në lajmërimin e thirrjes duhet të përcaktohet ora e fillimit të lidhjes telematike dhe vendet e audio – video konferencës të lidhura nën kujdesin e shoqërisë të cilëve do t'i bashkohen pjesëmarrësit: në cdo vend mbledhjeje duhet të mbahet një procesverbal i pjesëmarrjes.

7.4 Asambleja e zakonshme e ortakëve duhet të thirret së paku një herë në vit për miratimin e pasqyrave financiare. Koha e mbledhjes do të përcaktohet sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Art. 8 – Efikasiteti i vendimmarrjes së asamblesë

8.1 Asambletë e formuara dhe të thirrura rregullisht përfaqësojnë të drejtën universale të ortakëve dhe vendimet e marra në përputhje me ligjin dhe me aktin në fjalë i detyron të gjithë ortakët edhe ata të munguar ose kundërshtues me përjashtim të atyre që kanë përdorur të drejtën e tërheqjes sic parashikohet në ligj.

Art. 9 – Thirrja dhe vendi i Asamblesë

9.1 Asambleja e ortakëve e cila mund të mbahet si në selinë e shoqërisë ashtu edhe në vend tjetër do të thirret nga organi administrativ përmes një lajmërimi të dërguar ortakëve, këshilltarëve dhe anëtarëve të organit të kontrollit , nëse ata janë emëruar të paktën shtatë ditë përpara datës së përcaktuar për mbledhjen në adresën të cilën cdo i interesuar i ka komunikuar paraprakisht shoqërisë.

9.2 Lajmërimi i thirrjes duhet të përmbajë përshkrimin e ditës, orës dhe vendit ku do të mbahet mbledhja si edhe çështjet mbi të cilat asamblesë i kërkohet të marrë vendime.

9.3 Në të njëjtin lajmërim mund të fiksohet për një ditë tjetër një mbledhje e dytë në rast se e para nuk do kishte pjesëmarrje apo nuk do të mund të formohej rregullisht.

9.4 Lajmërimi mund të redaktohet në cdo lloj forme qoftë në letër apo elektronik dhe mund të dërgohet me anë të cdo lloj sistemi komunikimi për sa kohë sigurohet se mund të provohet marrja e këtij njoftimi.

9.5 Sipas nenit 83 paragrafi 2 të Ligjit 9901 të datës 14 prill 2008, do të konsiderohen gjithsesi të vlefshme vendimet e Asamblesë që nuk janë ngritur në formë të rregullt nëse të gjithë ortakët kanë marrë pjesë dhe kanë shprehur pëlqimin e tyre për të vendosur.

Art. 10 – Ndërhyrja dhe përfaqësimi në asamble

10.1 Mund të ndërhyjnë në asamble të gjithë ata që rezultojnë të jenë ortakë në datën e asamblesë.

10.2 Cdo ortak mund të përfaqësohet përmes një autorizimi të shkruar lëshuar ndaj kujtdo personi tjetër i cili mund të mos jetë domosdoshmërisht ortak, me përjashtimin e qartë të administratorëve të shoqërisë, të cilët sipas dispozitave që parashikon ligji kanë ndalimin absolut për të vepruar si përfaqësues të kujtdo ortaku.

10.3 Prokura/autorizimi mund të lëshohet vetëm për një mbledhje të vecantë, pa përjashtuar gjithashtu mbledhjet vijuese në vazhdimësi që kanë të bëjnë me të njëjtin "rend dite".



Art. 11 – Presidenti i asamblesë

11.1 Presidenti i asamblesë është ose administratori i vetëm ose presidenti i këshillit të administrimit, në rastin e emërimit nga një organ kolegjal ose në mungesë të tyre nga një person i përzgjedhur nga asambleja, që emëron një sekretar I cili mund të mos jetë ortak.

11.2 Vendimet e asamblesë duhet të paraqiten në një procesverbal të posacëm të firmosur nga presidenti dhe sekretari I mbledhjes; dhe në rastet e parashikuara me ligj, procesverbali duhet të redaktohet nga noteri.

11.3. Procesverbali duhet të ketë datën dhe vendin e mbledhjes, emrin e Presidentit dhe Sekretarit dhe rezultatin e vendimarrjes. Për më tepër, këtij të fundit duhet ti bashkëngjitet listëprezenca e pjesëmarrësve dhe akti i thirrjes së Asamblesë.

Art. 12 – Kuorumet e asamblesë

12.1 Siç përcaktohet me nenin 86 të Ligjit 9901 të datës 14/04/2008, Asambleja konsiderohet të jetë e rregullt, kur në të marrin pjesë ortakët që përfaqësojnë më shumë se 30% të kapitalit të shoqërisë.

12.2 Për vendimet e parashikuara në nenin 87 të Ligjit 9901 të datës 14/04/2008, Asambleja do të konsiderohet rregullisht e ngritur nëse janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë. Në thirrjen e parë, takimi është rregullisht i ngritur me praninë e ortakëve që përfaqësojnë të paktën gjysmën e kapitalit të shoqërisë dhe vendosin me shumicë absolute.

12.3 Në mungesë të kuorumeve të parashikuara në këtë nen, asambleja duhet të thirret jo më vonë se 30 ditë nga thirrja e parë. Në thirrjen e dytë, asambleja është mbledhur në mënyrë të vlefshme pa marrë parasysh pjesën e kapitalit shoqëror të përfaqësuar dhe zgjedh me votën e favorshme të shumicës së të pranishmëve.

12.4 Me urdhër të ditës të përcaktuar me nenin 81 të Ligjit 9901 të datës 14/04/2008, asambleja vendos me votën e favorshme të shumicës së pjesëmarrësve. Për më tepër, mbi modifikimet e aktit të themelimit dhe mbi emërimin dhe fuqitë e likuiduesve, asambleja mund të mbahet rregullisht dhe vendimet e saj të jenë të vlefshme qoftë në thirrjen e parë ashtu edhe në të dytën vetëm me prezencën e 75% të ortakëve dhe me votën pro të aq ortakëve sa të arrihet shumica e kapitalit të shoqërisë.

TITULLI IV

ADMINISTRIMI DHE PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

Art. 13 – Administrimi i shoqërisë

13.1. Kompania menaxhohet, në varësi të rezolutës të miratuar herë pas here nga mbledhja e aksionarëve, nga një drejtor i vetëm, ose nga një bord i drejtorëve i përbërë nga dy deri në pesë anëtarë, të emëruar edhe nga jo-anëtarë. Në pajtim me nenin 95 paragrafi 5 të Ligjit 9901 të datës 14.04.2008, në rast se shoqëria administrohet nga më shumë se një drejtor, si në rastin e Bordit të Drejtorëve ose të administratës, administratorët mund të zgjedhin të sigurojnë disjunktiv

13.2 Kohëzgjatja në detyrë e administratorëve është 5 vjetecare e rinovueshme.

13.3 Shpërblimi dhe pjesmarrja në fitime e administratorit të vetëm dhe anëtarëve të këshillit administrativ përcaktohen nga ortakët.

13.4 Administratorit të vetëm ose anëtarëve të këshillit administrativ, u takon gjithashtu edhe rimbursimi i shpenzimeve të kryera për arsye të detyrës së tyre.

13.5 Siç është parashikuar nga Neni 207 i Ligjit 9901 të datës 14/04/2008, drejtorët e shoqërisë mëmë nuk mund të emërohen drejtorë të një filiali / dege dhe anasjelltas. Çdo caktim në kundërshtim me këto dispozita do të konsiderohet si i pavlefshëm.



Art. 14 – Presidenti , zëvendës presidenti dhe administratori i deleguar

14.1 Bordi i Drejtorëve mund të zgjedhë nga radhët e anëtarëve një president dhe një zëvendëspresident i cili zëvendëson presidentin në rast mungese ose pengese, një ose më shumë administrator të deleguar dhe madje edhe jashtë anëtarëve të tij, një sekretar.

Art. 15 – Vendimet e këshillit administrativ

15.1 Vendimet e këshillit administrativ merren me mbledhje kolegjale.

15.2 Vota nuk mund të jepet përmes përfaqësimit.

Art. 16 – Mbledhja kolegjale e këshillit administrativ.

16.1 Këshilli administrativ do të mbledhet në selinë e shoqërisë ose në cdo vend tjetër në Shqipëri ose jashtë , cdo herë që presidenti do ta quajë të nevojshme dhe kur do të kërkohet me shkrim nga të paktën dy prej anëtarëve të tij ose nga organi i kontrollit nëse kemi një të tillë të emëruar.

16.2 Si rregull thirrja do të bëhet përmes lajmërimit me anë të cdo lloji sistemi komunikimi për sa kohë që mund të provohet marrja e kësaj thirrje përmes atij sistemi, këshilltarëve të paktën shtatë ditë para datës së përcaktuar për mbledhjen me përjashtim rasteve urgjente kur lajmërimi duhet të dërgohet të paktën tre ditë para mbledhjes.

Në të njëjtat terma lajmërohen edhe anëtarët e organit të kontrollit nëse ka një të tillë të emëruar.

16.3. Që rezolutat e këshillit të jenë të vlefshme, shumica e anëtarëve në detyrë duhet të jenë të pranishëm.

16.3 Këshilli administrativ mund të mbahet rregullisht dhe të quhet akt vendimmarrës edhe në mungesë të formaliteteve të sipërpërmendura , nëse në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij dhe anëtarët e organit të kontrollit nëse ka një të tillë të emëruar , pa anashkaluar të drejtën e secilit pjesmarrës për të kundërshtuar diskutimin e argumenteve mbi të cilat konsideron se nuk është informuar mjaftueshëm.

16.4 Mbledhja mund të mbahet edhe në audio – videokonferencë ose edhe vetëm në audiokonferencë për sa kohë janë siguruar të drejtat e pjesëmarrjes si më poshtë:duhet të zgjidhe një vend ku të jenë të pranishëm të paktën presidenti dhe sekretari i mbledhjes, duhet të bëhet i mundur identifikimi i saktë i personave të legjitimuar për të marrë pjesë në mbledhje, duhet të sigurohet mundësia e gjithsecilit për të ndërhyrë verbalisht mbi të gjitha argumentet e trajtuara si edhe për të vrojtuar apo marrë dhe përcjellë informacion në kohë reale. Egzistenca reale e të drejtave në fjalë duhet të konstatohet nga presidenti i mbledhjes i cili duhet t'i regjistrojë në procesverbalin e mbledhjes.

16.5 Mënyra e deklarimit të votës nuk duhet të anashkalojë faktin se në cdo rast duhet të jenë mënyra që lejojnë evidentimin e atyre që japin vota kundër ose abstenojnë , vendosen me shumicën absolute të votave të të pranishëmve.

Art. 17 – Vendime të marra me mbledhje kolegjale

17.1 Këshilli administrativ merr vendime të vlefshme me shumicë absolute të votave të anëtarëve të saj; në rast barazie të votave mbizotëron vota e presidentit për sa kohë këshilli të përbëhet prej më shumë se dy anëtarëve.

17.2 Vendimet e këshillit duhet të konstatohen nga verbal i transkriptuar në një libër të posaçëm të mbajtur sipas normave ligjore dhe nënshkruar nga presidenti dhe sekretari i mbledhjes.

Art. 18 – Fuqitë e organit administrativ

18.1 Organi administrativ është i veshur me fuqitë më të gjera të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të administrimit, me përjashtim të atyre që ky akt i rezervon si kompetenca ekskluzive të vendimeve të ortakëve me përjashtim të blerjes dhe shitjes së pasurive të patundshme dhe kërkesës për kredi, hua ose llogari bankare. Për këto të fundit, do të jetë e detyrueshme shqyrtimi i mëparshëm i Asamblesë së Zakonshme që do të duhet të japë pëlqimin e vet për këto operacione me votim të favorshëm të bashkëpunëtorëve që përfaqësojnë 75% të kapitalit shoqëror.

18.2 Këshilli i administrimit ose administratori i vetëm do të ketë pra, ndër të tjera, të drejtën për



të blerë, shkëmbyer, shitur pasuri të tundshme, automjete , ti përfshijë në shoqëri , të marrë aksione dhe interesa , të marrë dhe obligacione, të emerojë prokurues për akte ose kategori aktesh , drejtorë e cdo gjë tjetër që do të konsiderohet e domosdoshme për qëllimet e shoqërisë.

18.3 Në rastin kur shoqëria administrohet nga një këshill, këshilli mund të delegojë pjesërisht ose tërësisht atributet dhe fuqitë e tij tek Presidenti, Zv.Presidenti. apo tek një apo më shumë administratorë të deleguar duke përcaktuar paraprakisht modalitetet dhe kufijtë e ushtrimit të fuqive të deleguara.

Art. 19 – Firma dhe përfaqësimi i shoqërisë

19.1 Përvec rasteve të parashikuara në nenin e mëparshëm 18.3 , firma dhe përfaqësimi i shoqërisë i takojnë administratorit të vetëm ose presidentit të këshillit administrativ dhe/ose Administratorit të Deleguar.

19.2 Përfaqësuesit ligjorë të kompanisë mund të emërojnë përfaqësues me prokurë duke u dhënë atyre pjesë të kompetencave të tyre. Ky emërim duhet të bëhet vetëm përmes një akti noterial.

TITULLI V

ORGANI I KONTROLLIT

Art. 20 – Organi i kontrollit.

20.1. Nëse përmbushen predispozitat ligjore ose vendoset nga Asambleja, shoqëria emëron një organ mbikëqyrës, i cili mund të përbëhet nga një audit i vetëm ligjor ose një studio profesionale auditimi.

TITULLI VI

BILANCI – FITIMET

Art. 21 – Periudha fiskale ushtrimore , bilanci dhe fitimet.

21.1 Periudha fiskale ushtrimore mbyllet më 31 (tridhjetë e një) dhjetor të cdo viti. Periudha e parë ushtrimore mbyllet më 31 (tridhjetë e një) dhjetor 2021 (dymijë e njezetente) .

21.2 Bilanci i cili duhet hartuar në përputhje me dispozitat e patjetërsuara ligjore, duhet tu paraqitet ortakëve për miratim brenda afatit të 31 Marsit të cdo viti, përvec mundësive kur mund të ketë një afat më të gjatë brenda kufijve dhe kushteve të përcaktuara me ligj.

21.3 Fitimet neto të rezultuara nga bilanci do të ndahen kështu :

- 5 % (pesë për qind) në ngritjen e një fond rezerve ligjore , deri në arritjen e një shume të barabartë më një të katërtën e kapitalit të regjistruar;
- fitimi i mbetur do të shpërndahet ose do të lihet mënjanë në varësi të vendimeve të ortakëve që aprovojnë bilancin.

Në cdo rast , nesë verifikohet humbje kapitali , nuk mund të ketë shpërndarje fitimesh deri kur kapitali i shoqërisë të riintegrohet dhe të kthehet në masën e duhur.

TITULLI VII

SHKRIRJA, PËRJASHTIMI I ORTAKËVE, LIKUJDIMI DHE MOSMARRVESHJET

Art. 22 – Shkrirja

22.1 Shoqëria konsiderohet e shkrirë vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.

22.2 Në cdo rast shkrirje të shoqërisë , ortakët do të përcaktojnë një ose më shumë likuidatorë, duke përcaktuar gjithashtu fuqitë dhe shpërblimin e tyre.




Art. 23 – Dispozita të përgjithshme

23.1 Për gjithcka që nuk është shprehimisht e parashikuar në aktin e themelimit ose në këtë statut , do t'i referohet shprehimisht dispozitave ligjore ne fuqi në momentin konkret.

ORTAKU I SHOQERISE
z.DONALDO MUHAJ

Donaldo Muhaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE DURRËS

NOTER ENTELA P. FILO
ADRESA Lagja 11, Rr. A,GOGA,
GODINA NR.623, AP. NR.2, HYRJA
NR.1
TEL: 692063870

VERTETIM NENSHKRIMI

(STATUTI)

Nr. repertori: 3683

Durres më 09/09/2021




ENTELA P. FILO
Notere
Cel: 069 20 63 870



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"




V2021013590351511771

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER ENTELA P. FILO



DATE 09/09/2021
NR REP 3683



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 09.09.2021 , para meje Notere ENTELA P. FILO, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, Lagja 11, Rr. A,GOGA, GODINA NR.623, AP. NR.2, HYRJA NR.1, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Donaldo Muhaj, atësia Hamza, amësia Vjollca, shtetas Shqiptar, lindur në Durres dhe banues në DURRËS, me adresë Anastas Durrsaku 00690058; Nd. 15; H. 2; Ap. 20; Durrës; Durrës; 2025; Durrës, lindur më 23/11/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Biometrike nr. BD1533017 dhe nr. personal J111230570 , i cili në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Statutin e Shoqerise "NIKI GO TRANS" sh.p.k, bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjetit të identifikimit, në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

ENTE LA P. FILO

ENTE LA P. FILO

Notere

Cel: 069 20 63 870

